REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:183618
Datë: 09.02.2024
Numri i dokumentit: 05310570

CP.nr.87/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, përmes gjyqtarit individual Fuad Haliti dhe me bashkëpunëtorin profesional Eron Prekazi, në lëndën përmbarimore të kreditorit S.R nga Mitrovica, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. Gazmend Ismajli nga Mitrovica, ndaj debitorit Trepça Sh.A, jashtë seancës gjyqësore me datë 09.02.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përmbarimore e kreditorit S.R nga Mitrovica, ndaj debitorit Trepça Sh.A -Mitrovicë.

Arsyetim

Me aktvendimin e kësaj gjykate CP.nr.87/23 i datës 23.03.2023, është caktuar përmbarimi sipas propozimit të kreditorit S.R nga Mitrovica, ndaj debitorit Trepça Sh.A -Mitrovicë.

Me parashtresën e datës 02.06.2023, i autorizuari i kreditores, e ka njoftuar gjykatën se debitori e ka përmbushur obligimin ndaj kreditores.

Gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore e përfundoj procedurën përmbarimore pasi që detyrimi i debitorit ndaj kreditorit është përmbushur. i

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
CP.nr.87/2023, datë 09.02.2024

GJYQTARI
Fuad Haliti

_____

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditorë nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

2023:061718